



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 693/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me apelin e parashtruar nga Besim Ymeri, nga Vitia, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar apeli i parashtruar nga Besim Ymeri, nga Vitia, me shenjën ZL.An.693/2017 e datës 09.11.2017, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 14:35, ka pranuar një apel nga Besim Ymeri, nga Vitia, i cili pretendon se në Vendvotimin nr. 2601x/05d ka votuar subjektin politik AKR nr. 12 dhe se në atë vendvotim numëri 12 nuk ka asnjë votë. Ka kërkuar që të rinumërohen votat në vendvotimin nr. 2601x/05d.

Parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve ne apel ka bashkangjitur një Raport të vëzhgueseve, një Formular për regjistrimin e votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit e shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **apeli është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ne apel janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në qendrat e votimit të sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për apellesin.

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, refuzoj si të pabazuar apelin e apeluesit .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.693/2017 më datën 11.11.2017.

**Kryesuesja e Panelit**  
**Gjytene Sylejmani**



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*